



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2023:226981

Datë: 12.03.2024

Numri i dokumentit: 05441081

P.nr.09/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Benita Berisha, me zyrtarin ligjor Besart Mustafa, në çështjen penale ndaj të akuzuarit R. B., për shkak të veprës penale: Lëndimi i rëndë trupor nga neni 186 par. 1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë- Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1764/23 të datës 12.01.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik me datë 13.02.2024, në prezencë të Prokurorit të Shtetit Ajtene Zoni, të akuzuarit R. B. dhe mbrojtësit të tij sipas autorizimit av. Valdrin Islami si dhe përfaqësueses së palës së dëmtuar B. K., sipas autorizimit av. Nadire Koshi, me datë 15.02.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 12.03.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

R. B., nga i ati Xh., e ëma Xh., e vajzërisë S., i lindur me datë ..., në Mitrovicë, me vendbanim në rrugën "...", p.n., Mitrovicë, i pa martuar, i pa punë, ka të përfunduar shkollën e mesme-gjimnazin, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,(ka qenë në masën e paraburgimit nga data 24.10.2023 deri me datën 18.12.2023, ndërsa nën masën e arrestit shtëpiak 18.12.2023 deri më datën 15.02.2024).

ËSHTË FAJTOR

SEPSE:

Më datë 24.10.2023, rreth orës 15:10 në Mitrovicë, në rrugën "...", me dashje i shkakton lëndime të rënda trupore personit tjetër dhe atë të dëmtuarit B. K. në atë mënyrë që, i dëmtuari dhe i pandehuri kishin mosmarrëveshje të mëhershme, ndërsa në ditën kritike derisa i dëmtuari ishte duke ecur së bashku me bashkëshorten e tij në rrugën lartcekur, aty i del i pandehuri i cili papritmas e godet të dëmtuarin B. me grushte në pjesën e majtë afër syrit, me që rast i dëmtuari rrëzohet në tokë, e duke qenë i shtrirë në tokë, i pandehuri e godet me shkelma, e si rezultat i dëmtuari pëson lëndime të rënda trupore, lëndime të cilat janë konstatuar nga ekspertiza mjekoligjore thyerje komplekse të kockave të nofullës së djathtë, prani e gjakut në sinuset maxillare të anës së djathtë dhe ënjtje që si të tilla bëjnë pjesë në lëndime të rënda trupore.

Me këto veprime ka kryer veprën penale **Lëndimi i rëndë trupor nga neni 186 paragrafi 1 të KPRK-së**, (Kodi Penal i Republikës së Kosovës nr.06/L-074).

Andaj Gjykata në bazë të neneve: 1, 4, 7, 17, 21, 38, 40, 42, 43, 44, 69, 70, 79 lidhur me nenin 186 par.1 të KPRK-së, dhe neneve: 364, 365, 366, 449, 452 dhe 462 të KPP-së, të akuzuarit, i:

S H Q I P T O N

- I. Dënim me Burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. Në kuptim të nenit 44 të KPRK-së dhe me pëlqimin e të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, Dënimi me Burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj i zëvendësohet me Dënim me Gjobë në shumë prej katër mijë (4000) euro, të cilin dënim i akuzuari obligohet ta paguaj në afat prej 30 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, Gjykata do të veproj në bazë të nenit 43 par.3 të KPRK-së, ashtu që dënimin me gjobë mund t'ia zëvendësoj me dënim me burgim duke llogaritur për çdo 20 € (euro) gjobë me një (1) ditë burgim. Në dënimin e shqiptuar me gjobë i llogaritet koha e kaluar në masën e paraburgimit nga data 24.10.2023 deri me datën 18.12.2023 dhe koha e kaluar nën masën e arrestit shtëpiak nga data 18.12.2023 deri më datën 15.02.2024.
- III. Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor shumë prej tridhjetë (30) euro, në emër të fondit të kompensimit të viktimave të krimit shumë prej njëzet (20) euro si dhe në emër të ekspertizës mjeko- ligjore shumë prej njëzet (20) euro, të gjitha këto në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm.
- IV. Pala e dëmtuar B. K., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.
- V. Të akuzuarit R. B., gjykata me aktvendim të veçantë i ka ndërprerë masën e arrestit shtëpiak.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë- Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur Aktakuzën PP.II.nr.1764/23 të datës 12.01.2024 kundër të akuzuarit R. B., për shkak të veprës penale Lëndimi i rëndë trupor nga neni 186 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 13.02.2024, në të cilën kanë prezantuar Prokurori i Shtetit Ajtene Zoni, i akuzuari R. B. dhe mbrojtësi i tij sipas autorizimit av. Valdrin Islami, si dhe përfaqësuesja e palës së dëmtuar B. K., sipas autorizimit av. Nadire Koshi.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, të akuzuarit i është dhënë mundësia që të deklarohet lidhur me fajësinë, ashtu që në këtë seancë lidhur me pranimin e fajësisë i akuzuari ka deklaruar se ndjehet fajtor, e pranon fajësinë sipas aktakuzës duke shtuar se ka qenë hera e parë në jetën e tij që ka rënë ndesh me ligjin dhe do të jetë hera e fundit, kërkoi falje, i vie shumë keq për rastin që ka ndodhur. I akuzuari i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen veprime të tilla nuk do të përsëriten.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se, pajtohet me pranimin e fajësisë nga ane e të akuzuarit, ngase pranimi i fajësisë është dhënë në mënyrë vullnetare dhe pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, konform dispozitave ligjore te nenit 242 të KPP-së, pranimi i fajësisë ka mbështetje në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës. Po ashtu i ka propozuar gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor dhe t'i shqiptoj një sanksion penal me të cilin do të arrihet qëllimi i dënimit, ashtu që me rastin e caktimit dhe llojit të lartësisë së dënimit si rrethanë lehtësuese ta marrë parasysh: pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, ndërsa sa i përket rrethanave rënduese të marr parasysh shkallën e përgjegjësisë penale, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur si dhe faktin se si pasojë e kësaj vepre penale i dëmtuari ka pësuar lëndime të rënda trupore.

Përfaqësuesja e palës së dëmtuar B. K., av. Nadire Koshi lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se, pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, njëherit i ka propozuar gjykatës që të ketë parasysh se vepra penale është kryer në shkallë të lartë të dashjes nga ane e të akuzuarit R. B., e ka mbështetur në tërësi deklarinimin e prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Mbrojtësi i të akuzuarit R. B., sipas autorizimit av. Valdrin Islami, lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se, sa i përket pranimit të fajësisë i propozoi gjykatës që ta pranoj pasi që i njëjti është bërë pas konsultimit të mjaftueshëm me të si mbrojtës, po ashtu gjen mbështetje edhe në shkresat e lëndës. Sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit gjykatës i propozoi që të ketë parasysh rrethanat lehtësuese nga nenit 69 dhe 70 i KPRK-së dhe atë si rrethanë tejet lehtësuese pranimin e fajësisë në këtë fazë të procedurës penale, faktin se asnjëherë më parë nuk ka rënë ndesh me ligjin dhe nuk është zhvilluar asnjë procedurë tjetër penale ndaj të njëjtit, faktin se i njëjti ka kërkuar falje dhe ka shprehur pendim të thellë lidhur me veprimet e tij, faktin se i njëjti ka bashkëpunuar me organet e ndjekjes penale, e po ashtu edhe kushtet e dobëta ekonomike. Duke u bazuar në rrethanat në të cilat është kryer vepra penale i ka propozuar gjykatës që ta zbus dënimin nën minimumin e lejuar konform nenit 71 dhe 72 të KPRK-së, e nëse gjykata i shqipton dënimin nën 6 muaj të njëjtin dënim ta zëvendësoj me dënim me gjobë konform nenit 44 të KPRK-së, duke pasur parasysh edhe faktin se i njëjti afër 4 muaj është privuar nga liria, edhe me dënime të tilla do të arrihet qëllimi i dënimit.

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i akuzuari, e në mbështetje të nenit 242 të KPP-së, në këtë drejtim ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të akuzuarin.

Gjykata ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykatë si: Raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2023-BC-1188, i datës 24.10.2023, Procesverbal mbi marrjen në pyetje të dëshmitares E. M. i datës 24.10.2023, Procesverbal mbi marrjen në pyetje të dëshmitarit Xh. B. i datës 24.10.2023, Procesverbal mbi marrjen në pyetje të dëshmitarit D. P. i datës 24.10.2023, Fotoalbum nga Dosja e Forenzikës me numër 240/23, i datës 24.10.2023, Video incizimi në CD, Raportet mjekësore nga Spitali i Përgjithshëm Emergjencja në Mitrovicë me numër 26256, të datës 24.10.2023, Flet lëshimi nga Klinika e Kirurgjisë Maksillofaciale me numër 595/23, Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes, i datës 24.10.2023, Ekspertiza mjeko-ligjore e datës 31.10.2023, nga Dr.N. U., Procesverbali mbi intervistimin e të pandehurit R. B. i datës 24.10.2023 dhe procesverbal mbi marrjen në pyetje në procedurë paraprake në PTH Mitrovicë i datës 24.11.2023 si dhe shkresat tjera të lëndës. Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë të këtyre provave dhe pranimi të fajësisë, konsiderojmë se përtej çdo dyshimi është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në mënyrë vullnetare, dhe pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, duke e njoftuar të akuzuarin se pas pranimi të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, por vetëm sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i akuzuari.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë së të akuzuarit dhe nga provat e cekura si më lartë, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i akuzuari R. B. ka kryer veprën penale: Lëndimi i rëndë trupor nga neni 186 par.1 të KPRK-së, ku sipas paragrafit 1.3 të këtij neni, për këtë vepër penale është paraparë dënimi me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së. Gjykata, si rrethanë veçanërisht lehtësuese ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale nga i akuzuari në seancën e shqyrtimit fillestar, si rrethana lehtësuese gjeti keqardhjen e shprehur dhe pendimin e thellë për veprën e kryer, premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të përsërisë më veprime të tilla si dhe faktin se i akuzuari sipas evidencës penale të kësaj gjykate me nr.532.24, të datës 15.02.2024, asnjëherë më parë nuk ka qenë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë. Ndërsa, rrethana rënduese në rastin konkret nuk gjeti.

Gjykata vlerëson se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e aktgjykimit, është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit. Po ashtu gjykata vlerëson se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimin lidhur me zëvendësimin e dënimit me burgim me dënim me gjobë, gjykata e mori konform nenit 44 të KPRK-së.

Vendimin për llogaritjen e kohës së kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak, në dënimin e shqiptuar me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata e mori në bazë të nenit 79 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe atë të paushallit gjyqësor dhe ekspertizës, u mor në bazë të nenit 449 par. 2 nën par. 2.1 dhe 2.6 dhe nenit 452 par. 1 të KPP-së. Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 36 par. 3 nën. par 3.1 të Ligjit nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Në bazë të nenit 462 par. 2 të KPP-së, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Gjykata, të akuzuarit me aktvendim të veçantë P.nr.09/2024 të datës 15.02.2024, i ka ndërprerë masën e arrestit shtëpiak konform nenit 366 par.1 nën par.1.2 lidhur me nenin 181 par.7 të KPP-së, ku edhe janë dhënë arsyet për një vendim të tillë.

Nga sa u tha më lartë e konform dispozitës të nenit 364 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr.09/2024, të datës: 12.03.2024

Zyrtari Ligjor
Besart Mustafa

Gjyqtarja e vetme gjykuese
Benita Berisha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj Gjykate.